



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË - DEGA E GJYKATËS RAHOVEC

Numri i lëndës: 2022:243217

Datë: 03.06.2024

Numri i dokumentit: 05768905

CP.nr.243/2022

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË – DEGA NË RAHOVEC, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, gjyqtari Avni Berisha, në çështjen juridike të përmbarimit sipas propozimit për përmbarim të kreditorit të përmbarimit, H.M nga Prizreni, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson avokati D.M nga Prizreni, paraqitur kundër debitorit të përmbarimit Komuna e Rahovecit-Drejtoria Komunale e Arsimit, për përmbarimin në bazë të dokumentit të përmbarueshëm Vendimit të Drejtorisë së Arsimit të Komunës së Rahovecit, për pagesën e tri pagave përcjellëse me rastin e daljes në pension në shumën prej 1,632.78, i lejuar me urdhrin për përmbarim, CP.nr.243/22 të datës 15.11.2022, nga Gjykata Themelore në Gjakovë-dega në Rahovec, duke vendosur sipas detyrës zyrtare, jashtë seancës gjyqësore, më datën 10.05.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

- I. **KONSIDEROHET** i tërhequr propozimi për përmbarim i kreditorit të përmbarimit, H.M nga Prizreni, i paraqitur kundër debitorit të përmbarimit Komuna e Rahovecit-Drejtoria Komunale e Arsimit, për pagesën e tri pagave përcjellëse me rastin e daljes në pension në shumën prej 1,632.78, ashtu që përfundon procedura në këtë çështje përmbarimore.
- II. **HIQET NGA FUQIA** urdhri përmbarimor CP.nr.243/22, i datës 15.11.2022, i lejuar nga Gjykata Themelore në Gjakovë-dega në Rahovec, si dhe të gjitha veprimet përmbarimore të ndërmarra në këtë procedurë.
- III. Secila palë i bartë shpenzimet e veta të procedurës.

A r s y e t i m

Kreditori H.M nga Prizreni përmes përfaqësuesit të tij të autorizuar av. D.M, me datë 15.11.2022, ka paraqitur propozimin për përbarim kundër debitorit të përbarimit Komuna e Rahovecit-Drejtoria Komunale e Arsimit, me të cilën ka kërkuar pagesën e tri pagave përcjellëse me rastin e daljes në pension në shumën prej 1,632.78, gjykata duke vepruar sipas propozimit të kreditorit për përbarim ka lëshuar urdhër CP.nr.243/22, i datës 15.11.2022, me të cilin ka lejuar përbarimin në bazë të dokumentit, Vendimit të Drejtorisë së Arsimit të Komunës së Rahovecit, i cili parashihet si dokument i përbarueshëm në nenin 22, paragrafi 1, pika 1.2 të LPP-së.

Gjykata pas shqyrtimit të shkresave të lëndës ka konstatuar se në propozimin për përbarim Vendimi numër 260 i datës 11.05.2022, i lëshuar nga Komuna e Rahovecit-DKA dhe të gjitha dokumentet tjera të bashkangjitura janë në formatin fotokopje, e jo në formatin origjinal siç kërkohet me nenin 38 par.1 të LPP-së në të cilin përcaktohet se *“Propozimi për përbarim duhet ta përmbajë kërkesën për përbarim në të cilën do të tregohet dokumenti përbarimor origjinal apo kopje e vërtetuar, apo dokumenti i besueshëm në bazë të cilit kërkohet përbarimi, kërkuesi i përbarimit dhe debitori, adresa e vendbanimit – vendqëndrimit apo selisë afariste të kreditorit dhe të debitorit, kredia që kërkohet të realizohet, si dhe mjeti nëpërmjet cilit duhet kryer përbarimi, objekti i përbarimit po qe se është i njohur, si dhe të dhënat e tjera që janë të nevojshme për zbatimin e përbarimit”*

Gjykata me konkluzion CP.nr.243/2022 i datës 04.07.2023, ka kërkuar nga kreditori që në afat prej tre (3) ditëve ti siguroj dokumentet origjinale apo kopjet e vërtetuara, duke e njoftuar për pasojat ligjore se në të kundërtën nëse kreditori nuk e përmirëson propozimin do të konsiderohet se e ka tërhequr, nëse e kthen të pa përmirësuar, do të hedhet poshtë.

Gjykata me rastin e vlerësimit të parashtresës së dorëzuar nga përfaqësuesi i autorizuar i kreditorit av. D.M, vlerësoj se i njëjti nuk është paraqitur brenda afatit tre (3) ditore, e që një fakt të tillë gjykata e ka vërtetuar nga fletëkthesa e cila gjendet në shkresat e lëndës nga e cila konstatohet se kreditori konkluzionin CP.nr.243/2022 i datës 04.07.2023, e ka pranuar me datë 11.07.2023, ditë e martë, andaj afati ka filluar të rrjedh nga dita e mërkurë data 12.07.2023, ndërsa dita e fundit për paraqitjen e prapësimit ka qenë data 14.07.2023, ditë e premte, ndërsa kreditori dokumentin origjinal e ka paraqitur me datë 17.07.2023, pra pas kalimit të afatit.

Meqenëse në nenin 17 të Ligjit për Procedurën Përbarimore (në tekstin e mëtejme LPP) është përcaktuar se: *“Në procedurën përbarimore përshtatshmërisht zbatohen dispozitat e Ligjit për Procedurën kontestimore, po qe se me këtë ligj ose me ndonjë ligj tjetër nuk parashihet diçka tjetër”*, atëherë në këtë rast gjejmë zbatim dispozitat nga neni 102 i paragrafit 3 të Ligjit për Procedurën Kontestimore ku është paraparë se: *“Do të konsiderohet se është tërhequr parashtresa po qe se nuk i kthehet gjykatës brenda afatit të caktuar, e në qoftë se i kthehet pa u korrigjuar, gjegjësisht pa u plotësuar, parashtresa do të hidhet poshtë”*,

Lidhur me shpenzimet procedurale u vendos duke u mbështetur në nenin 13 të LPP-së.

Nga të lartcekurat, e në bazë të nenit 17 të LPP-së, lidhur me nenin 38 , par. 1 dhe 102, par.1 dhe 3 të LPK-së gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendim

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË – DEGA NË RAHOVEC
Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Civil
CP.nr.243/2022, më datën 10.05.2024.

Gjyqtari
Avni Berisha

UDHËZIMI JURIDIK: Kundër këtij aktvendimi, lejohet ankesa në afat prej 7 (shtatë) ditëve, nga dita e pranimit. Ankesa ushtrohet përmes kësaj gjykate, për gjykatën e Apelit në Prishtinë, Divizioni Civil.